



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	02
Nr. Prot. Broj. Prop. Prot. No.	05-7542
Nr. i faqëve Br. stranica No. pages	-4-
Data: Datum: Date	23 11 2023
Prishtinë / a	


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE (PSO)

- EMRI I PSO:** Për pagesën e bordeve, komisioneve, komiteteve dhe trupave tjerë profesional në Ministrinë e Shëndetësisë
- PËRMBAJTJA:** Përshkrimi i procedurës

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT: 21/11/2023
AUTOR: MSh
NR. I HAPAVE: 4
NR. I NËNHAPAVE: 15

APROVUAR:


Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë



Nëntor 2023
Prishtinë

QËLLIMI	Procedura standarde ka për qëllim të rregulloj procedurën e pagesave për trupa profesionale të MSh-së që janë emëruar me vendim të Ministrit dhe kompensohen për punën e tyre sipas Ligjit Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik.
NDËRLIDHJA ME AKTET	<p>Baza ligjore për pagesën e trupave profesionalë të MSh-së</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në sektorin publik; - Rregullore (QRK) Nr. 10/2023 për kompensimin e funksionit shtesë; <p>Baza ligjore për emërimin e trupave profesionalë të MSh-së dhe AKPPM</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi; - Ligji Nr. 04/L-190 për pajisje dhe produkte medicinale; - Udhëzimi Administrativ nr. 01-2023 për shkollim specialistik; - Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) nr. 10/2011 për regjistrimin dhe licencimin e profesionistëve shëndetësor; - Udhëzimi Administrativ nr. 03-2019 për hartimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike; - Udhëzimi Administrativ nr. 06/2013 për frytnimin e asistuar mjekësor; - Udhëzimi Administrativ nr. 09/2014 për licencimin e institucioneve private shëndetësore; - Udhëzimi Administrativ nr. 04/2006 për edukimin themelor profesional dhe provimi i licencës për punëtorët shëndetësor; - Udhëzimi Administrativ MF-Nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik. - Udhëzimi Administrativ Nr.05/2015 bordi i ankesave; - Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) Nr. 01/2022 për thjeshtëzimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale që nuk kanë Paralele të autorizuara në Republikën e Kosovës; - Udhëzimi Administrativ (MSH) Nr.06/2014 për përcaktimin e listës së produkteve medicinale, pajisjeve medicinale dhe produkteve të linjës kufitare për të cilat nevojitet autorizimi për Import apo Eksport; - Udhëzimi Administrativ (MSH) Nr.13/2013 për qarkulluesit me shumicë për produktet dhe pajisje medicinale; - Udhëzimi Administrativ (MSH) Nr.11/2015 për qarkulluesit me pakicë për produktet dhe pajisje medicinale; - Udhëzimi Administrativ (shëndetësi) Nr.04 2015 Komisioni për Vlerësimin e Produkteve Medicinale dhe Pajisjeve Medicinale;
LISTA E SHKURTESAVE	<p>MSh - Ministria e Shëndetësisë;</p> <p>BQSHS - Bordi qendror për shkollim specialistik;</p> <p>BLPSH - Bordi për licencim të profesionistëve shëndetësor;</p> <p>BLIPSH - Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore;</p> <p>BQRL - Bordi qendror për regjistrim dhe licencim;</p> <p>KLIPSH - Komisionet për licencimin e institucioneve private shëndetësore;</p> <p>KAS - Komisioni i ankesave për specializim;</p> <p>KALIPSH - Komisioni i ankesave për licencim të IPSH-ve;</p> <p>KKHUPK - Këshilli Kosovar për hartimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve;</p> <p>KA - Komiteti i auditimit;</p> <p>KIVF - Komisioni për IVF;</p> <p>AKPPM - Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;</p> <p>KVPPM - Komisioni për vlerësimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale;</p> <p>BA - Bordi i ankesave;</p> <p>KRPP - Komisioni për regjistrimin e produkteve pa paralele.</p> <p>KRPPM - Komisioni për kategorizimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale</p> <p>KVKQSHPPM - Komisioni për vlerësimin e kërkesave të qarkulluesve me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale për pranimin e ndryshimeve jo me shumicë se 5% të kushteve për licencim;</p> <p>KVKQPPPM - Komisioni për vlerësimin e kërkesave të qarkulluesve me pakicë për produkte dhe pajisje medicinale për pranimin e ndryshimeve jo me shumicë se 5% të kushteve për licencim;</p> <p>ZKA – Zytari Kryesor Administrativ;</p>
SHËNIM	<p>Të gjithë trupat profesionale analoge të cilat emërohen me vendim të Ministrit dhe derivojnë nga legjislacioni në fuqi, kompensohen duke u bazuar në Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 Për Kompensim Për Funksionin Shtesë.</p> <p>Zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë të cilët shërbejnë në borde, komisione dhe trupa tjera profesionale nuk marrin kompensim për angazhimin e tyre në këto trupa.</p>

PROCEDURA

Nr	HAPI	NËN-HAPAT
I	Evidentimi i vendimit të nxjerrë nga Ministri	<ol style="list-style-type: none"> 1. Verifikimi i vendimit për kompensim nga departamenti përkatës; 2. Evidentimi i anëtarëve sipas vendimit të ministrit (borde, komisione dhe trupa tjerë profesionalë që kompensohen për punën e tyre), bazuar në Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 Per kompensim për Funkcionin Shtese; 3. Lista për pagesa përgatitet nga zyrtarët të cilat e kanë për detyrë mbështetjen e trupave profesionale brenda Departamenteve për takimet e mbajtura, bashkë me procesverbale të nënshkruara; në të kundërtën kjo listë përgatitet brenda Bordit, Komisionit dhe trupave tjerë profesional;
II	Evidentimi i takimeve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lista duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin, nr. personal, kodin buxhetor dhe shumën e pagesës; 2. Brenda një muaji duhet të mbahet të paktën një takim si parakusht për pagesë; 3. Në rast kur bordi, komisioni apo trupa tjetër profesionale mbledhet më rrallë se një herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje; 4. Lista për kompensim hartohet në baza mujore;
III	Zbatimi i tarifave	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pagesa e bordit, komisionit dhe trupës tjetër profesionale, për një muaj llogaritet si në vijim: <ol style="list-style-type: none"> 1.1. Pagesa mujore e kryesuesit të bordit, komisionit apo trupës tjetër profesionale është 30% e pagës bazë të zyrtarit kryesor administrativ të organizatës; 1.2. Pagesa mujore e anëtarit të bordit, komisionit apo trupës tjetër profesionale është 20% e pagës mujore të zyrtarit kryesor administrativ të organizatës; 1.3. Në raste kur funksioni shtesë nuk konfirmohet me saktësi, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë jep vlerësim nëse funksioni i ngarkuar mbetet funksion jashtë detyrave të rregullta të punës; 1.4. Kryesuesi dhe anëtarët do të kompensohen vetëm për një bord ose komision brenda një organizate.

IV	Dokumentet që duhet të bashkëngjiten dhe afatet e procedimit të pagesave	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e dokumentacionit bëhet nga Bordi/ Komisioni/ trupa tjetër profesionale, dhe duhet ti përmbajë këto dokumente: <ol style="list-style-type: none"> 1.1. Kërkesat për pagesa bëhen për trupë të caktuar dhe jo në mënyrë individuale; 1.2. Shkresa përcjellëse e nënshkruar nga kryesuesi i bordit, komisionit dhe trupave tjera profesionale; 1.3. Vendimi për emërim të anëtarëve (kopje); 1.4. Procesverbalet e takimeve, të nënshkruara; 1.5. Listën e ndarë të anëtarëve në baza mujore; 1.6. Listën me total të pagesës; 2. Para se të dërgohen në procedurë për pagesë i gjithë dokumentacioni kalon përmes departamentit përkatës, për kontrollë dhe zbatim të kësaj PSO-je; 3. Pas kontrollit nga udhëheqësit e departamentit/divizionit apo njësisë, pagesa procedohet për aprovim të ZKA; 4. Divizioni i burimeve njerëzore përgatit listën finale dhe shkresat përcjellëse për ekzekutim të pagesave në Divizionin e pagesave në MFPT; 5. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e trupave profesionale nuk është në sistemin e pagave, kompensimi ekzekutohet përmes Divizionit të financave në MSh apo AKPPM; 6. Listat e pagesave me dokumente përcjellëse sipas kësaj PSO-je, duhet të dorëzohen në fillim të muajit, jo më larg se data 5 e muajit; 7. Mos dërgimi dhe kompletimi i dokumenteve për pagesa deri me datën e cekur me lartë, mbetet përgjegjësi e zyrtarëve kompetent për dërgimin e tyre;
----	--	--